



“Tetori Rozë”, ministri Vengu: Shëndeti dhe siguria juaj në themel të çdo aktiviteti të FA-së



Këshilli i Ministrave miratoi projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Sllovenisë mbi Bashkëpunimin në Mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”

Këshilli i Ministrave miratoi projektligjin “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Sllovenisë dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë mbi Bashkëpunimin në Mbrojtje ndaj katastrofave natyrore dhe të tjera”. Kjo marrëveshje për bashkëpunimin në fushën e emergjencave civile do të ndikojë në mënyrë të konsiderueshme në rritjen e mëtejshme të kapacitetit dhe reagimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë dhe Agjencisë Kombëtare të Mbrojtjes Civile në përballimin e situatave të krijuara nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera. Sipas marrëveshjes, kjo ndihmë e ndërsjellët mund të përfshijë ekipe shpëtimi dhe ekspertë individualë, pajisje mbrojtëse dhe shpëtimi dhe ndihmë humanitare. Për të siguruar një ndihmë

më të shpejtë dhe më të efektshme në mbrojtje dhe shpëtim dhe në eliminimin e pasojave të një fatkeqësie, në bazë të kësaj marrëveshjeje, palët do t’iu japin ekipeve të shpëtimit dhe ekspertëve individualë, që ofrojnë ndihmë, një procedurë të thjeshtuar për kalimin e kufirit shtetëror, duke marrë parasysh kushtet e aplikueshme të hyrjes. Po ashtu në marrëveshje përcaktohet se avionët dhe anijet mund të përdoren për transport emergjent të ekipeve të shpëtimit ose ekspertëve individualë që ofrojnë pajisje ndihme, mbrojtjeje, shpëtimi dhe lloje të tjera të ndihmës në përputhje me këtë marrëveshje. Ndërsa përdorimi i avionëve ushtarakë dhe anijeve ushtarake për qëllimet e kësaj marrëveshjeje lejohet vetëm në marrëveshje me shtetin pritës. Marrëveshja pritët të ratifikohet edhe në Parlament.



Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura, gjeneralmajor Arben Kingji vizitoi Qendrën e Trajnimit Profesional të Ushtarëve në Bunavi, dhe Regjimentin e Këmbësorisë së Jugut në Poshnje. Ai u takua nga afër me rekrutë, kadetë dhe studentë, të cilët po zhvillojnë programin e stërvitjes individuale bazë, faza e parë e procesit transformues ushtarak që i pajis me njohuritë bazë profesionale për të shërbyer devotshmërisht në radhët e Forcave të Armatosura.



Ministri i Mbrojtjes z. Pirro Vengu vizitoi Shkollën e Trupës, në Bunavi nga ku dha një mesazh për të gjitha gratë dhe vajzat, pjesë të Forcave të Armatosura, në kuadër të “Tetorit Rozë”, muajit të ndërgjegjësimit kundër kancerit të gjirit.

I shoqëruar edhe nga ministrja e Shëndetësisë znj. Albana Koçiu, ministri Vengu u shpreh se, është përgjegjësi e Ministrisë së Mbrojtjes që të kujdeset në mënyrë të posaçme për shëndetin dhe mirëqenien e grave dhe vajzave të Forcave të Armatosura.

“Ne jemi të vetëdijshëm për përgjegjësinë sociale që kemi si Ministri e Mbrojtjes dhe si FA, për t’iu gjendur pranë në çdo sfidë shëndetësore, aq më tepër që kjo sfidë ka tendencë të shtrihet dhe të bëhet më e rrezikshme. Prandaj, parandalimi dhe veprimet ndërgjegjëse kanë një domethënie të veçantë. Ky mesazh nuk duhet të shkojë vetëm për gratë dhe vajzat, por edhe për burrat dhe djemtë, të cilët duhet të jenë mbështetje për koleget, motrat, nënat dhe bashkëshortet e tyre”, - theksoi Ministri i Mbrojtjes. Ministri falënderoi ministren e Shëndetësisë, znj. Albana Koçiu për vendosjen në dispozicion të FA-së të njësive lëvizëse të diagnostikimit, në mënyrë që oficeret, nënoficeret e rekrutet e reja në Bunavi të realizojnë diagnostikimin dhe kontrollin parandalues për kontrollin e gjirit.

“Vetëm bashkë mund të ndërtojmë një mjedis, ku shëndeti dhe siguria juaj janë në themel të çdo aktiviteti që keni në FA. Unë, personalisht, së bashku me ju dhe ekipin, premtoj se do të marrim iniciativë që shëndeti juaj të jetë në bazë të çdo aktiviteti të formimit, ndërgjegjësimit dhe mirëqenies, jo vetëm për ju, por edhe për familjet tuaja”, - u premtoi ministri Vengu grave dhe vajzave në uniformë. Një prej të prekurave nga kjo sëmundje, nënkolonel Esmihan Durbaku, gjatë fjalës së saj në këtë takim, u bëri thirrje të gjitha grave brenda familjes së FA-së, por edhe të gjitha grave shqiptare të mos neglizhojnë kontrollin.

Nga ana e saj, ministrja e Shëndetësisë, znj. Albana Koçiu u shpreh se, të gjitha gratë duhet të marrin pak kohë për t’u diagnostikuar, me qëllim që zbulimi i sëmundjes të bëhet në fazë të hershme: “Ne menduam që do të ishte një mundësi shumë e mirë për të folur edhe këtu e për të ndërgjegjësuar gratë, vajzat, por edhe familjarët, për rëndësinë që ka diagnostikimi i hershëm për kancerin e gjirit”, - u shpreh ministrja Koçiu, duke i cilësuar gratë dhe vajzat në uniformë një shembull frymëzimi. Ministrja e Shëndetësisë i ftoi që përveçse gjatë muajit të tetorit, ato ta kryejnë kontrollin edhe gjatë gjithë vitit. Aktualisht, Forcat e Armatosura numërojnë 1.642 gra, nga të cilat 955 janë nën uniformë, përfshirë 395 oficeret, 360 nënoficeret dhe 200 ushtarë, të cilat kanë mundësi të përfitojnë nga kontrollin falas në këtë muaj të ndërgjegjësimit.

“Tetori Rozë”, ministri Vengu: Shëndeti dhe siguria juaj në themel të çdo aktiviteti të FA-së



Zvogëlimi natyral i risqeve nga fatkeqësitë, temë e vizitës së një grupi të përbërë nga institucionet e interesit në Japoni

Një grup përfaqësues nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC), Agjencia Kombëtare e Pyjeve (AKP), Instituti i Gjeoshkencave (IGJEO), Autoriteti Shtetëror për Informacionin Gjeohapësinor (ASIG) dhe Ujësjellës Kanalizimet Tiranë (UKT), zhvilluan një vizitë studimore në Tokio, Japoni, në kuadër të projektit “Ndërtimi i Kapaciteteve për Sistemin Kombëtar të Informacionit për Zjarret në Pyje (NFFIS) dhe Zgjidhjet e Bazuar në Natyrë për Zvogëlimin e Risqeve nga Fatkeqësitë (NbS-DRR)”, një vend ku 70% e sipërfaqes përbëhet nga pyje.

Gjatë kësaj vizite, e cila kishte për qëllim shkëmbimin e përvojave dhe praktikave më të mira në menaxhimin e pyjeve dhe zbatimin e metodave për zvogëlimin e risqeve natyrore, përfaqësuesit shqiptarë morën pjesë në trajnime intensive me ekspertët japonezë, të cilët prezantuan strategjitë më të përparura për parandalimin dhe menaxhimin e zjarreve në pyje. Këto trajnime përfshinin teknika për përdorimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë për zvogëlimin e risqeve nga fatkeqësitë, si dhe për aplikimin e teknologjive të reja për mbrojtjen e burimeve natyrore.



Grupi shqiptar vizitoi institucione si Agjencia e Pyjeve dhe Agjencia e Menaxhimit të Zjarreve dhe Fatkeqësive, ku u prezantuan projekte për mbrojtjen e pyjeve dhe metodat për kontrollin e erozionit, si dhe u demonstruan aktivitetet më të fundit për menaxhimin dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore.

Grupi shqiptar vizitoi institucione si Agjencia e Pyjeve dhe Agjencia e Menaxhimit të Zjarreve dhe Fatkeqësive, ku u prezantuan projekte për mbrojtjen e pyjeve dhe metodat për kontrollin e erozionit, si dhe u demonstruan aktivitetet më të fundit për menaxhimin dhe parandalimin e fatkeqësive natyrore.

Eksperienca të tilla e ndihmojnë AKMC-në në misionin për forcimin e kapaciteteve kombëtare për menaxhimin e zjarreve në pyje dhe zbatimin e zgjidhjeve inovative për zvogëlimin e risqeve natyrore në Shqipëri.



Në vijimësi të aktiviteteve promovuese “Ditë të Hapura”, të rinjtë dhe të rejat u njohën më nga afër me kriteret dhe procedurat e rekrutimit, si dhe avantazhet që ofrojnë Forcat e Armatosura për një arsimim cilësor dhe karrierë të sigurt.

Komandanti i AFA-së, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj priti Atasheun gjerman, nënkolonel Hans Peter Wasler

Akademinë e Forcave të Armatosura e vizitoi atasheu gjerman, nënkolonel Hans Peter Wasler, i cili u prit nga Komandanti i Akademisë së Forcave të Armatosura, gjeneral brigade Bardhyl Nuredinaj.

Gjatë këtij takimi u diskutua bashkëpunimi në fushën e arsimit ushtarak, shkëmbimi i programeve mësimore me interes të përbashkët, pjesëmarrja në veprimtari kërkimore-shkencore, si dhe krijimi i mundësive të ushtarakëve tanë për ndjekjen e ciklit të tretë të studimeve (doktoraturave).



Përfundoi Kursi Bazë dhe i Avancuar i Kërkim - Shpëtimit në zonat urbane, Pomozatin, Kosovë

10 efektivë të Kompanisë së Kërkim - Shpëtimit në bazën e mbështetjes dhe emergjencave civile, përfunduan “Kursin Bazë dhe të Avancuar të Kërkim - Shpëtimit në zonat urbane”, i cili u zhvillua në Qendrën Ndërkombëtare të Kërkim - Shpëtimit në Pomozatin, Kosovë.

Ky kurs i organizuar në dy nivele, atë bazë dhe të avancuar, shërbeu për rritjen profesionale të efektivëve, duke i pajisur me njohuritë bazë e më të specializuara për të reaguar dhe mbështetur popullsinë në rast të fatkeqësive natyrore dhe njerëzore, të tilla si tërmete, aksidente masive, shembje objektiv. Për më shumë se një muaj, kursantët përvetësuan koncepte bashkëkohore në lidhje me metodat, parimet dhe procedurat e përdorura për realizimin e operacioneve në mbështetje të emergjencave civile.

Përmes stërvitjeve në terren, me anë të skenarëve të ndryshëm, përfshirë dhe rastin e një tërmeti, personeli i kursit të kërkim - shpëtimit në zonat urbane, demonstroi përgatitje të lartë, duke kryer veprime konkrete ditën dhe natën për kërkimin dhe evakuimin e personave të mbetur nën rrënoja, tërheqjen dhe lëshimin e të plagosurve me litar, dhënie të ndihmës së parë.



Përfundoi ndërtimi i urës tip “Bailey” në fshatin Rragam, bashkia Shkodër

Ekipi i ekspertëve në kompaninë e urave në Batalionin e Xhenios, realizuan me sukses detyrën për ndërtimin e urës tip “Bailey”, në fshatin Rragam, njësi administrative Gur i Zi, bashkia Shkodër.

Për më shumë se një javë efektivët e kompanisë së urave punuan intensivisht dhe pa ndërprerje, duke iu dhuruar banorëve të fshatit Rragam, urën metalike me gjatësi 18 metra me seksion 2/1 dhe peshëmbajtje 40 ton.

Kjo urë, e cila do të lidhë fshatrat Gjoç, Rragam dhe Mazrek, do ti shërbejë komunitetit, duke lehtësuar dhe përmirësuar jetesën e tyre të përditshme.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

A gëzojnë sot qeniet humane parime dhe vlera morale të cilat janë vija ndarëse me qeniet shtazore?

Aristoteli i madh mes shumë thënieve të tij të mençura tha: “Shkëlqimi i moralit ndodh si pasojë e vesit. Ne bëhemi të drejtë, duke bërë vepra të drejta, të përmbajtur, duke bërë vepra të matura, trima, duke bërë vepra guximtare”.

Sot duket se këto rregulla, sjellje, parime e ndjenja dhe këto veti pozitive të njeriut as që duken në horizont, as që janë prezente në jetën tonë. Sikur të ketë rënë një breshër dhe t’i ketë zhdukur nga faqja e dheut këto veti pozitive njerëzore. Pra sot as që mund të flitet për moral, rregulla a parime apo norma njerëzore.

Dikur ajo që konsiderohej e virtytshme ishte e përcaktuar qartë. Një njeri ose ishte i ndershëm, besnik, i dëlirë dhe i respektuar, ose jo. Sot, termin «virtyt» e ka zëvendësuar termi «vlera morale», çdo njeri ka të drejtën të zgjedhë se çfarë të konsiderojë virtyt e çfarë jo.

Vlerat morale mund të jenë bindje, mendime, qëndrime, ndjenja, zakone, norma të mirësjelljes, parapëlqime, paragjykime madje edhe shije personale, pra çfarëdo gjëje që një individ, grup ose shoqëri vlerëson në një kohë të caktuar për çfarëdolloj arsyeje.

Në shoqërinë e sotme liberale, njerëzit ndihen të justifikuar për të zgjedhur vlerat e veta morale, siç do të zgjidhnin ushqimet në supermarket.

Po atëherë, ç’do të ndodhë me atë që është vërtet e virtytshme dhe e moralshme?

Si kurrë më parë, raportet e shoqërisë me etikën dhe të sjelljes njerëzore me moralin janë bërë shumë të paqarta dhe kaotike.

Përmasat e reja të këtij fenomeni janë bërë shumë të dukshme edhe në shoqërinë shqiptare. Kjo është arsyeja pse besoj se të gjithë si qytetarë kemi shqetësimin social, pikërisht për situatën morale të dalë jashtë kontrollit.

Shumë karakteristika etike e vlera të sjelljes morale të sjelljes së njerëzve që kanë qenë tipike në të kaluarën, po zhduken nga ndikimet e forta të postmodernitetit dhe për pasojë, gradualisht po ato zëvendësohen nga jeta morale e turbullt, etikisht e pasigurt, shpirtërisht e zbrazët.

A është morali i shoqërisë në krizë, apo është vështirësuar adaptimi i tij me kohët e sotme moderne?

Duket qartë që në të ashtuquajturën kohë moderne situata morale ka ndryshuar dhe si rrjedhojë edhe sjellja sociale dhe komportimi etik i njeriut postmodern. Natyrisht, tipari esencial i kohës sonë dhe kushti për të gjetur zgjidhje të reja dhe adekuate morale për kohën, është teza e debatueshme nëse morali është shumëfishim apo shuarje e sistemit të vlerave të kohës së kaluar, të realitetit ekzistues dhe realitetet e reja të kohës moderne që po jetojmë? Padyshim deri sa të ekzistojë shoqëria njerëzore, është e natyrshme të besohet se edhe funksionimi moral i jetës do të ketë si kusht ekzistencial idenë se, pavarësisht individualizimit etik dhe diversitetit të sjelljes personale të njeriut, ai në mënyrë të natyrshme do të jetojë dhe lëvizë brenda disa parametrave humane e kontureve morale të qenies së njësuar nga korniza etike funksionuese e kohës.

Në kohën e sotme ka një shqetësim etik universal, që shfaqet në mënyrë evidente edhe në shoqërinë tonë. Ajo në thelbin e vet ka të bëjë me procesin e zgjeruar e gjithnjë e më shumë të përhapur të braktisjes së vlerave etike dhe zëvendësimin e tyre me “parime të reja” morale.

Bota po përballlet me procesin e një lloj falimentimi moral e shpirtëror, i cili në kohën e sotme është bërë më i rrezikshëm se falimentimet e mundshme financiare, të cilat janë më të rikuperueshme. Në vend të jetës me bazament moral, njerëzit kërkojnë një jetë me bazament të sigurt individual, madje këtë ndjesi sigurie materiale, që po zëvendëson dukshëm vlerën dhe nevojën e “sigurisë morale”, njerëzit janë gati ta “blejnë” me çdo çmim. Në konstatimin tim personal, për të cilin shumë dua të jetë i

‘Bëni si pemët, ndryshoni gjethet por ruani rrënjët. Ndryshoni idetë por ruani parimet’



gabuar, po shtohen njerëzit, të cilët nga mungesa e “stofit moral” personal, shndërrohen në qenie që e lënë veten në duart e të tjerëve, duke e bërë kështu jetën personale pa vlera morale, të vlerësuar dhe të kontrolluar nga të “tjerët” apo të “varur” tërësisht nga faktorët e jashtëm jo moralë.

Mungesa e vlerësimit të moralit dhe zbehja e njeriut nga nevoja e ngutshme e respektimit të rregullave etike, po krijon kushtet sociale për krijimin e njerëzve të pa lidhur moralisht.

Morali dhe ndikimi i tij social, sot po shfaqen të pafuqishëm përballë forcës së rregullave të tregut, magjisë së pushtetit dhe ndikimit determinant të parasë mbi vlerat morale të shoqërisë. Në këto kushte duket me shumë vështirësi mundësia që të realizohet procesi i “riarmatimit moral” të shoqërisë, sepse është proces që pengohet, jo nga fakti se njerëzit janë të prirur moralisht të zgjedhin rrugën e gabuar, por ngaqë shoqëria krijon kushte dhe ka sjellë modele të paravendosura të ndërtimit vetëm material dhe përgjithësisht jo moral të jetës së njeriut.

Bota postmoderne i ka dhënë prioritet njeriut, që është i aftë të gjejë e përpusojë mekanizmin e “racionalizmit instrumental”, për të realizuar qëllimet materiale, por nuk bën gjë kur është fjala për racionalizimin e vlerave morale të njeriut në jetën e përditshme. Kjo është arsyeja pse është masivizuar procesi i përballjes me një tjetër lloj njeriu, i cili përgjithësisht është pa dimension moral, i ftohtë, arrogant, materialist dhe që operon me parimet instrumentale të “qenies efikase” dhe njeriut pragmatist.

Tani shoqëria ka krijuar njeriun pa dimension moral, të dhënë tërësisht pas qëllimeve personale dhe interesave materiale që janë bërë “lënda e vetme djegëse” që vë në lëvizje motorin social të

shoqërisë së sotme. Koha po tregon për fat të keq se jeta e njeriut nuk po ecën drejt përmirësimeve morale apo drejt së ardhmes së sigurt etike.

Në kohën tonë kjo situatë të çon në pranimin e konstatimit filozofik, se sa më i dobët të bëhet në shoqëri sistemi funksionues i vlerave morale, aq më i fortë duhet të bëhet organizimi i vullnetit pozitiv e qytetar i njeriut.

Erozioni i vlerave tradicionale dhe rënia e moralitetit në “jetët komunitare” është mjaft shqetësues, fëmijët e shekullit XXI rriten dhe edukohen në mënyrë të tillë që të qëndrojnë në këmbët e tyre të palëkundur që herët në jetë. Këta bëhen të rinj të pavarur politikisht dhe ekonomikisht, shumë më herët se sa brezat e mëparshëm, por e gjitha kjo ka edhe koston e saj. Pavarësisht ekspozimit kaq të madh ndaj njohurive dhe zhvillimeve teknologjike, kompleksiteti në shoqërinë moderne vazhdon të rritet. Konkurrenca për të qenë në avantazh ndaj tjetrit “vret” vlerat njerëzore të përkujdesjes, ndarjes me të tjerët, dhe pranimin e tyre me zemër. Duket sikur gjithçka është transformuar në një “luftë pa rregulla” për fitime materiale. Duket sikur të rinjtë i kanë harruar disa rregulla sociale që duhen zbatuar. Rrallë shoh të rinj që thonë “Faleminderit!” për shërbimet që marrin, qoftë edhe nëse ky falënderim shkon për kamerierin që u shërben atyre kafën e mëngjesit.

Nuk mendoj se Europa do të na pranojë ne si shoqëri me këtë diskurs të madh, të mos kuptuarit se, etika, parimi dhe ndërgjegjja janë personale, por kusht i domosdoshëm për bashkëjetesën kolektive të një shoqërie, e cila duhet t’i ketë primare këto norma që kultivohen përgjatë jetës me njeriun.

Lufta në Skërficë të Fushëbardhës dhe dëshmorët e saj



Prof. Asoc. Dr. Zaho GOLEMI

Në Qafë të Skërficës të Fushëbardhës, më datën 19.10.2024, u përurua “Shtëpia” e dëshmorëve që luftuan 110 vjet më parë me andartët grekë. Miq e dashamirës të shumtë nga qarku Gjirokastrë e Vlorë, deputetë të Parlamentit Shqiptar, kryetari i Gjykatës së Lartë, Sokol Maliq Sadushi, deputeti Petro Koçi e Vullnet Sinaj, Dino Selimi, Tërmet Peçi, Ardi Veliu, Ardit Bido, prof. Rami Memushaj, Irfan Bilbilaj, prof. Bernard Zotaj, që përfaqësonte edhe kryetarin e Labërisë Agim Çiraku, Arben Bllaci, Flamur Hasimi, që përfaqësonte edhe Kryetarin e OKDA dr. Gjergj Velo, msc. Behar Salillari nga Departamenti i Dëshmorëve në MM, dr. Gjergj Bizhga, dr. Arnold Pashaj, Abaz Goxhaj, klerikë të shquar Hysen Shehu, dervish Mikel Onjea, dervish Ermal Hoxha nga Krahësi, dervish Hetem Resuli nga Koshtani, Mareglen Basho, Gazmend Allkja, Luan Muca, Ëngjëllush Bellaj, Mitat Bellaj, Alush Kërra, Astrit Muho, Sefer Muho, dhe anëtarë të SHKA-së “Fushëbardha”, SHHUSH, SHAK-së “Labëria”, Shoqatat “Vajzë”, “Dukaj”, “Kallarat”, “Dr. Bilal Golemi”, “Lunxhëria”, Organizata e Dëshmorëve, veteranëve, Dega e Labërisë së Sarandës, grupet polifonike të Fushëbardhës dhe Zhulati, etj., që morën pjesë dhe nderuan në përrurimin e memorialit të Skërficës dhe përkujtimin të nëntë dëshmorëve të rënë në luftën e Skërficës, më 20 deri më 25 qershor 1914. Merrte pjesë edhe e dërguara e posaçme e kryetarit të Bashkisë së Delvinës Besmir Veli, znj. Erinda Seitaj njëherazi edhe kryetare e Këshillit Bashkiak të Delvinës, të dërguar të posaçëm të kryetarit të Bashkisë së Gjirokastrës Flamur Golemi, por edhe mjaft pjesëmarrës nga Krahina e Kardhiqit, Rrëzomës, Delvinës, Sarandës, Gjirokastrës; Organizatorët ishin nga SHKA “Fushëbardha”, Nexhip Onjea, Zaho Golemi, Trifon Golemi, Pajtim Bello, Dervish Mikeli, Hoshho Onjea, Angjelo Kazo, Teli Resuli, Ana Kazo, Adriatik Cama. Memoriali i Skërficës i hap rrugën memorialit të ri që do bëhet në Senicë për 5 dëshmorë në kuadrin e 80-vjetorit të çlirimit të Atdheut.

Përkujtohet lufta e përgjakshme që u zhvillua më shumë se një shekull më parë në Qafë të Skërficës, në qafën që ndan e bashkon Gjirokastrën me Delvinën, në qafën që konsiderohet një ndër portat e Labërisë, që ka pritur e përcjellë përmes këtyre shtigjeve në shekuj bij të Labërisë që shkonin e vinin luftërave në mbrojtje të truallit arbëror. Lufta e Skërficës është ngjarja më madhore e 110 viteve më parë, një luftë e përgjakshme njëjavore që ka ngelur në memorien e shqiptarëve si qëndresë luftarake dhe mbijetesë në mbrojtje të truallit shqiptar, të Labërisë.

Skërfica, Fushëbardha, mbarë fshatrat e Labërisë dhe më gjerë kanë qenë dhe kanë mbetur një nga gjësimet e shumta luftarake të historisë shqiptare dhe më të përgjakshme që tashmë studiohet edhe në Akademinë Ushtarake shqiptare. Lufta e Qafës së Skërficës u zhvillua pas kuvendit të Shtëpëzimit të 10 prillit 1914, në kohën kur nisi mësymja masive për të shfarosur Jugun e Shqipërisë, të pabindur ndaj qeverisë autonomiste të Zografos, betejës së Cepos e masakrave të shumta në të gjithë jugun e vendit tonë. Është fakt se për këtë luftë të përgjakshme u mobilizuan gjithë resurset e mundshme materiale luftarake e njerëzore të shqiptarëve.

Fakt ishte se gjithë Jugu i Shqipërisë ishte në luftë. Për luftën e



Skërficës mobilizimi ishte maksimal dhe organizatorët ishin banorët e Fushëbardhës, ku i ra për pjesë mbrojtja e fshatit, por dhe gjithë Labërisë për t'i shpëtuar vrasjeve dhe djegieve masive të andartëve të pamëshirshëm. Fakt është se për këtë luftë çeta e Fushëbardhës doli në frontin e saj në Skërficë me luftëtarë të udhëhequr nga kryeplaku dhe komandanti i çetës së Fushëbardhës Halil Sullo, por luftuan edhe luftëtarë nga Delvina, Gjirokastra, krahina e Rrëzomës, krahina e Kardhiqit, Libohova, Çamëria etj. Porta e Labërisë nga ana jugore ishte hyrja nga Luvadhi në Skërficë drejt Fushëbardhës. Skërfica ishte një luftë lokale, ku fqinjët tanë synonin jugun e Shqipërisë, shfarosjen e një popullate autoktone që jetonte në truallin mijërvjeçar. Kjo çoi fqinjët jugorë drejt objektivit strategjik të vjetër, ku ushtria bashkë me andartët shkaktuan shkatërrime masive, masakra e barbari të panjohura. Lufta në Skërficës nuk është një betejë e shkëputur e vitit 1914. Ajo është vijimësi qëndrese e nisur në frontin e kryeqendrës së vilajetit Janinës si dhe në frontet e tjera të luftës. Në Skërficë foli gryka e pushkës, por edhe me gurë dhe me çfarë të mundnin çeta e Fushëbardhës, më 20 qershor 1914, dërgoi një postë të përparuar zbulimi me 12 luftëtarë tek Gurët e Bashe, që kryenin zbulim mbi kampin andart të vendosur në Qafë të Luvadhit.

Ishin këta 12 luftëtarë që ndezën të parët qëndresën. Çeta u rrit me shpejtësi nga 40 vetë, vetëm në pak orë në rreth 120 luftëtarë, me komandant Halil Sullon ish-kryeplak dhe komandant i çetës që shkroi histori qëndrese deri në largimin e fshatrave drejt Vlorës. Agresorët me 450 andartë e ushtarë, të drejtuar nga shtabi madhor i vendosur në Jorgucat e Delvinë. Kjo forcë mbështetej edhe nga 1500 andartë të skalionuar, të pajisur me armët më moderne të kohës, përfshi artilerinë. Batalioni me andartë e ushtarë dhe major Korjaskonis, e mbylli me turp karrierën në Skërficë përballë trimërisë labe dhe jo vetëm. Shtabi madhor akademik i fqinjëve, i pajisur me taktika, strategji, armatime e topa dështoi kundër kryengritësve popullorë të formuar në “akademinë” e betejave populllore. Në Skërficë i thanë “ndal!”, grabitjes së tokave arbërore, në një pozicion strategjik natyral, si një xhephane lufte, ku shqiptarët kishin pritur me jatagan dhe me pushkë pushtuesit në gjithë epokat dhe shekujt. Në mbështetje të frontit të luftës së Skërficës ishin burra, gra, pleq, dhe fëmijë, të drejtuar nga trimi, kryeplaku luftëtarë e organizatori Halil Sullo, të vendosur për mbrojtjen me çdo kusht të Qafës së Skërficës deri në largimin e krejt popullatës së fshatrave që andartët kishin vendosur t'i dignin plotësisht dhe të shfarosnin çdo frymor të kësaj zone. Forcat andarte depërtuan në shtigje të fshehtë të Skërficës në drejtim të Pilloit, që ishte edhe një ndër faktorët e përshpejtimin të tërheqjes drejt Vlorës të popullatës. Qafa e Skërficës u kthye në istikam qëndrese të përgjakshme. Artileria shkëmbore e përdorur me aq mjeshtëri në periudha e kohë të ndryshme në Shqipëri, u përsërit edhe në Skërficë. Drejtimi i Gjinitishtës dhe Vrahollit u kthyen në kala qëndrese nga ku rrokulliseshin gurët masivisht nga vëllezërit Dervish, Hadër e Medi Yzeiri dhe luftëtarë të tjerë.

Përgjakja një javore përfundoi me rënien në fushëbetë të shumë dëshmorëve, një humbje të konsiderueshme me 9 luftëtarë shqiptarë të vrarë dhe 60 të plagosur; ndërsa forcat andarte lanë në Skërficë rreth 60 të vrarë dhe rreth 120 të plagosur. Garantimi i tërheqjes së banorëve të fshatrave në drejtim të Vlorës, u realizua pasi andartët depërtuan përmes “kalit të Trojës”, nga mali i Pilloit, në Qafën e Skërficës. Kështu që luftimi vijoi nga njëra llogore në tjetrën në thellësi. Kameniku, Vraholl, Gurët e Bashe, Gropa e Dërrasës, Qafa e Skërficës u kthyen në kala qëndrese natyrore të pakapërcyeshme pushtimi.


Fushëbardhas dhe bashkë-krahinas nga Krahina e Kardhiqit dhe Rëzomës shkruan epope trimërie dhe rikonfirmuan atë që shqiptarët nënshkruanin për lirinë në betejë me gjak heroizmi. Lajmërimet për tërheqjen e popullatës drejt Vlorës e transmetonte Komandanti i

çetës nëpërmjet korrierit të luftës së Skërficës Cenko Onjea. Ditë e natë gjithë mbështetja e popullatës ishte për luftën, për frontin e Skërficës. Ndërkohë ishte vrarë edhe dëshmori 22 vjeçar Cenko Onjea në lëndinë të blertë të Qafë Dardhës sipër Fushëbardhës. Por çeta vijoi të luftonte kundër andartëve dhe ushtrisë me një qëndresë të pashembullt historike, duke luftuar trimërisht, pa mbështetje të strukturave qeveritare, kur qeveria e Ismail Qemalit kishte dhënë dorëheqje që në janar 1914, por edhe pa mbështetje të Qeverisë së Vidit dhe as ushtarakëve të xhandarmërisë holandeze që ishte prezent në vendin tonë, ku mund të themi që edhe sabotimi i luftës së shqiptarëve bëhej nga Tomsoni, që bënte pakt me grekët në marrëveshjen e Korfuzit. Kërcënimi i Skërficës, që ishte edhe një ndër pesë portat hyrëse të Labërisë, ishte serioz dhe u mbrojt vetëm me gjak. Në flakë u ndezën Shpella e Dhespinës, Shkëmbi i Kaze, Nomeja e Qershisë, Përroi i Shametit, Qafa e Trullave, Gropa e Dërrasës, Vrahull e deri në Qafë të Skërficës. Tashmë historia e rënies së dëshmorëve është e dokumentuar dhe shkruar në memorien e Labërisë dhe gjithë shqiptarëve: Halil Sullo komandanti i çetës që u vra në hyrje të Shkëmbit të Skamanos; Dalip Kondi u plagos rëndë në të majtë të Qafës së Skërficës sipër përroit të sipërm e shkoi në drejtim të “Përroit të Shametit” dhe vdiq tek piksaret, eshtrat e të cilit janë gjetur pas tre vjetësh në sipërfaqe bashkë me pjesën metalike të pushkës; Mete Jonuzi ra heroikisht tek Kroj i Resule, pranë Gurëve të Bashe; Sejdi Baho u plagos rëndë në “Gropën e Gjeshtres” dhe ndërroi jetë në spital në Tepelenë; Rizal Muho u vra tek Nomeja e Panjës mbi Kamenik, ku për një shekull vendi i rënies u thirr “Lisi i Rizal Muhos”; Halil Norra u vra në Qafë të Skërficës, në të djathtë të kroit të sipërm të Skërficës (kur e shikon nga Qafa e Luvadhit nga ana jugore); Surja Tefa i plagosur rëndë luftoi trimërisht në Qafën e Trullave me mauzer dhe nagant, pa u dorëzuar dhe kur jeleku ishte mbuluar me gjak luftoi deri në vdekje e nuk dorëzohej edhe nga torturat çnjerëzore të andartëve. Në xhephanen e Cepos ra dëshmor Haxhi Muxhai nga Zhulati dhe sa e sa djem nga gjithë Jugu i Shqipërisë.

Dëshmorët e Skërficës janë në panteonin e përjetshëm të mirënjohjes së kombit, por lufta kishte edhe dhjetëra të plagosur si Murat Cama, Hadër Uzeiri, etj., të cilët pas shërimit të plagëve morën pjesë dhe në Luftën e Vlorës më 1920. Në Skërficë nuk u bë pakt me dredhinë, nuk u kërkua “besë” nga pabesia. Lufta ishte e ashpër edhe më në thellësi të Labërisë, në Zhulat, Golem e deri në Kuç, Kallarat, Bolenë, Borsh, Llogora etj. Shqiptarët u trupëzuan me qafën-kala natyrore të Skërficës, dhe ngelën në panteonin e kombit dhe në memorien populllore. Dëshmorët janë dhëndurë lirie në panteonin e kombit, janë në kujtesën shqiptare dhe janë në lapidar përjetësisht në Skërficë dhe në Fushëbardhë. Memoriali-lapidar që ngriti fshati Fushëbardhë me brigadën e saj të ndërtimit, të viteve 70-të të shekullit të kaluar, nuk u la në harresë. Gjaku i dëshmorëve që ranë në këtë betejë në Luftën e Skërficës (20.6.1914 deri 25.6.1914) mbetet një apel për mos përsëritje të kësaj historie të hidhur. Fushëbardha, gjithë treva përreth, Labëria nuk mund të harrojnë gjakun e derdhur. Kjo luftë ka hyrë në axhendën kombëtare të studimeve historike ushtarake të luftërave të popullit shqiptar, ku kanë rënë 9 dëshmorë: Halil Sullo (1864 -1914), Halil Norra (1886 -1914), Surja Tefa (1887 -1914), Rizal Muho (1889 -1914), Sejdi Baho (1889 -1914), Dalip Kondi (1892 -1914) Cenko Onjea (1892 -1914), nga Zhulati Haxhi Muxhai (1883 -1914), dhe nga Golemi: Mete Jonuzi (1887 -1914). Fiset e tyre jetojnë sot edhe në trevën e bashkisë së Gjirokastrës, Delvinës e më gjerë. Poeti, atdhetari, luftëtar dhe doktori, që lidhi plagët e luftës në Skërficë, Ramiz Harxhi para më shumë se një shekulli do të shkruante në SHBA: “...Të pavdekur janë gjithë ata luanë,/Për nder të kombit u grin’e u vranë...”. Këngët për Qafën e Skërficës të pagëzuar tashmë si Qafa e Dëshmorëve janë të shumta: Në Skërficë që u ndez flakë./ Luftë ditë e luftë natë, /Lufton Halili (Sullo) me Dalipnë (Kondin)./ U gjakosnë për të mbrojtur Shqipërinë. /Seç nderojnë historinë, /Me gjak e shtuan lavdinë...”, si dhe “Lufta seç u ndez në qafë./Të parët vanë djemtë tanë, Halili me Cenko djalnë, Rizali me Surjanë, Halili me Dalip asganë, Metja me Sejdinë, Ç’e nderuan Shqipërinë...”, “...Fushëbardha maja e qafa mali./S’ të përkuli dot junani./Se kishte zotë vatani, /U ngulët te istikami,/Nga Luvadhi në Skërficë, / Edhe nata bëhej ditë,/Dyqind burra të stërralltë,/ Luftarakë djemtë tanë,/ Për lirinë dhe për vatanë...”.

Kohët kanë ndryshuar, por historia ngelet dhe kur jemi të ulur në tavolinat e sigurisë botërore edhe në strukturat ekonomike europiane, sikurse ngelet ngatërrestar i ashtuquajtur “ligj lufte”. Me fqinjët tanë jemi në NATO, organizmin më të madh dhe më të sigurt të sigurisë Botërore. Me fqinjët do të jemi edhe në Bashkimin Europian, por identiteti kombëtar do të ngelet i pandryshuar dhe larg nacionalizmave. Paqja dhe vetëm paqja dhe vëllazëria e Popujve dhe kombeve do të çojë njerëzimin përpara në prosperitet ekonomik dhe siguri kolektive. Nderimi dhe respekti për dëshmorët që ngelen në lapidar është nderim për veprën heroike të luftëtarëve të Skërficës, është nderim për gjakun e derdhur të dëshmorëve për Shqipërinë tonë të dashur.





Korça, djepi i kulturës dhe arsimit në 133-vjetorin e 'Shkollës së Parë të Vashave'

23 tetor 1891, 133 vite nga hapja e "Shkollës së Vashave" në Korçë, nga familja e njohur Qirjazi.

Themelimi i shkollës së parë shqipe në Korçë, e njohur zyrtarisht më 1887 frymëzoi Gjerasim Qiriazin dhe motrën e tij Sevasti Qiriaz-Dakon të hapin një shkollë për vajza. Me ndihmën e Naim Frashrit dhe veçanërisht misionarëve amerikanë dhe anglezë, ata i siguruan lejet e nevojshme nga Stambolli. Personeli i shkollës në vitet e para sipas Polikseni Luarasi përbëhej nga: Gjerasim Qiriaz, drejtor, Sevasti Qiriaz, Thanas Sina Postenani dhe Fanka Eftim. Mësues të tjerë që kanë dhënë mësim në këtë shkollë janë edhe patriotët e shquar Grigor e Katerina Cilka, Gjergj Qiriaz, Kristo Dako, Parashqevi Qiriaz, nxënës të kësaj shkolle Polikseni Luarasi, Helidhona Titu (Falli), amerikanët Fineas e Violet Kenedi të Misionit Amerikan, etj.

Në planin mësimor të shkollës përfshiheshin 18 lëndë, (shoqërore, shkencore e artistike) midis të cilave mësimi i lexim-shkrimit shqip, gramatika shqipe, historia e Shqipërisë etj.

Shkolla u hap në shtëpinë e Grigor Eliadhe Frashërit, pranë kishës së Shën Gjergjit, shtëpi në të cilën Gjerasimi me të motrën Sevastia banonin me qira. Sevastia kujton se atë ditë erdhën "tri vajza mjaft inteligjente e premtuese, vetëm për shkak të lajmit që ishte përhapur në qytet. Fillimi ishte shumë i thjeshtë, por kur mbyllëm vitin shkollor, në qershor, numri kishte arritur në 27 nxënës, më shumë nga çfarë kishim guxuar edhe të shpresonim si fillim lidhur me punimin e një toke kaq të fortë".

Polikseni (Dhespoti) Luarasi, e shoqja e patriotit Kristo Luarasi, një nga tri nxënëset e para të kësaj shkolle dhe e diplomuara e parë e saj e kujton kështu hapjen e shkollës shqipe të vashave: "Shkolla u hap në një dhomë të shtëpisë ku banonte Gjerasim Qiriaz. Dhomën e ktheu në një sallë mësimi, vuri ca bango sipas moshës së nxënësve, rregulloi një katedër për mësonjësin, një dërrasë të zezë për të shkruar dhe harta gjeografike nëpër mure. Kështu lindi bërthama e parë e shkollës shqipe të vashave në Korçë".

Në shtator 1892 shkolla u çel në ndërtesën e re që bleu Gjerasimi në lagjen e re aty afër vendit që quhej "Çezma e Arave". Aty vazhdoi derisa u mbyll, më 10 korrik të vitit 1914.

Hierarkia e Kishës Ortodokse kundërshtoi me ngulm shkollën që nga fillimi. Më 14 nëntor 1892, Gjerasim Qiriaz themeloi Vëllazërinë Evangjelistë të Shqipërisë në Korçë dhe mbante shërbime në objektin e shkollës. Për shkak të popullaritetit tij, për një kohë edhe Kisha Ortodokse filloi të mbajë shërbesa në shqip. Gjerasim Qiriaz ishte autor i poezive, këngëve, skeqeve, dialogëve dhe librave shkollor dhe redaktoi e përktheu tekste për Shoqërinë Biblike dhe për shkollën.

Që nga viti i parë i çeljes së kësaj shkolle 1891, deri në vitin 1913, numërohen 23 vite shkollore. Kanë studiuar 1028 nxënës. Numri mesatar i nxënësve ka qenë rreth 44 nxënës në vit. Viti



1905-1906 viti me numrin më të madh, 87 nxënës.

Pas vdekjes së Gjerasimit, në vitin 1894, vendin e tij e zuri i vëllai Gjergj Qiriaz e më pas Thanas Sina e Grigor Cilka.

Edit Durham, pas vizitës në Korçë në vitin 1903, e përshkruante kështu shkollën e Vashave: "Zonjusha Kyrias (Sevasti Qiriaz), një grua shumë e përgatitur dhe kurajoze, pati shkuar në Amerikë me ndihmën e misionarëve amerikanë, që trajnuar atje dhe kur u kthye në Korçë që emëruar drejtore të një shkolle femërore nën patronazhin e Misionit Amerikan. Sevasti përdorte tekste shkollorë amerikanë dhe jepte mësim në gjuhën shqipe. Mbas mbylljes së shkollës mashkullore të Korçës, kjo mbeti e vetmja shkollë në Shqipërinë Jugore, ku mund të mësohej shkrim e këndim në gjuhën shqipe.

"Edhe pse frekuentimi i asaj shkolle sillte rrezikun që vajzat

dhe prindërit të ishin persekutuar nga autoritetet turke, klasat ishin gjithmonë plot. Vajzat krishtere dhe myslimane mësonin të shkruanin dhe të lexonin në shqip dhe i mësonin edhe vëllezërve të tyre. Shkolla e Vashave ishte kaq moderne sa që më dukej se isha kthyer papritur në Europë".

Në vitin 1907 autoritetet osmane u përpoqën ta mbyllnin shkollën, por pa sukses. U tentua përsëri të mbyllej në vitin 1910, por tashmë shkolla ndodhej nën administrimin dhe mbrojtjen direkte të Misionit Amerikan, i cili kishte një marrëveshje me Portën e Lartë për ushtrim të lirë të veprimtarisë. Prandaj përfaqësuesi i këtij misioni në Korçë protestoi dhe refuzoi që kjo shkollë të mbyllej. Shkolla u mbyll më 10 korrik 1914, kur kishte nisur Lufta e Parë Botërore dhe ushtria greke kishte hyrë në Korçë.

Banda Frymore, tingujt që frymëzuan shpirtin luftarak të Kombit Shqiptar

Më 18 tetor 1944, u krijua Banda Frymore e Ushtrisë Nacionalçlirimtare, në Priskë të Tiranës - Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura, formacioni muzikor i vlerësuar me titullin e lartë “Kalorës i Urdhrit të Flamurit”. Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura, është trupë artistike profesioniste e “radhëve të blerta” të FA-ve shqiptare, e përbërë nga kontingjente të përzgjedhura muzikantësh, konform standardeve të kërkuara. Si formacion muzikor, ajo u krijua më 18 tetor 1944, në fshatin Priskë të Tiranës, ku me urdhër të Shtabit të Korparmatës së Parë të Ushtrisë Nacionalçlirimtare, u grumbullua një grup i madh muzikantësh partizanë dhe u formua orkestra frymore e këtij formacioni të madh partizan. Pas Çlirimit, kjo orkestër u plotësua me të gjithë elementet e nevojshëm të një bande muzikore moderne dhe e tillë vazhdon të jetë edhe sot. Në fillim ajo u quajt Orkestra Frymore e Ushtrisë Kombëtare dhe më vonë Orkestra frymore e Ushtrisë Popullore. Ajo është pjesë e rëndësishme e ceremonive zyrtare të shtetit shqiptar, që i jep tonin solemn momenteve të zbatimit të protokollit shtetëror. Që nga krijimi i saj e deri më sot, ajo ka një histori shumë të pasur aktivitetesh të rëndësishme që përbëjnë edhe pjesën më të qenësishme të krenarisë së saj legjitime. Aktivitetet artistike të realizuara prej saj janë shtuar, veçanërisht pas anëtarësimit të Shqipërisë në NATO, pjesë e së cilës janë edhe Forcat e Armatosura shqiptare, pas vitit 2008.

...Pararendëse e Bandës Muzikore “Vatra” që frymëzoi vullnetarët shqiptaro-amerikanë, pjesëmarrës në Luftën e Vlorës në vitin 1920.

Zanafilla e këtij formacioni kompleks muzikor, në fakt qëndron në vetë shpirtin luftarak të Kombit shqiptar, në historinë e tij të luftërave shekullore kundër çdo pushtuesi të huaj. Ritualet e kahershme kur binin trimat në luftë, apo kur ata varroseshin me të gjitha nderet që iu takonin, më pas shoqëroheshin nga këngët e trimërisë, që brenda tyre kishin tinguj që të bëjnë të ndjehesh krenar. Dhe kjo krenari pastaj përcillej nga brezi në brez. Kështu, një moment i rëndësishëm që evidenton qëllimin dhe misionin e madh që ka patur Orkestra Frymore e Forcave të Armatosura në historinë pararendëse të saj, ka qenë viti 1920, dhe pikërisht Lufta e Vlorës. Referuar Historisë së Shqipërisë, nuk ke se si të mos ndjehesh krenar, kur nëpër rreshta lexon se si 120 vullnetarë shqiptaro-amerikanë, të mbledhur dhe të përgatitur nga federata “Vatra” në SHBA, erdhën në Shqipëri për të dhënë ndihmën e tyre për çështjen kombëtare shqiptare, duke lënë Amerikën për të ndihmuar Atdheun edhe përmes muzikës e koncerteve të saj, që u shtrinë nga Shkodra në Gjirokastrë, nga Elbasani në Korçë, për të dalë në Drashovicë, ku ishte ndezur Lufta e Vlorës. Me këngët e saj, Banda Muzikore “Vatra” mbajti lart moralin e forcave që luftonin furishëm në Tepelenë, Drashovicë dhe kudo përreth qytetit të Vlorës”. Kjo luftë e



pashembullt, ku luftonte një popull i vogël dhe i paarmatosur me një fuqi të madhe, kishte marrë përmasat e një betejë epike. Dhe po epike u bë edhe kënga “Vlora-Vlora”, simboli i kësaj lufte: “Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,/ Rroki armët, bëja fora!/ Vlora, Vlora, Vlora, Vlora,/ Bjeri më të lumtë dora!”. Dhe siç dihet, kjo këngë simbol, e kënduar nga Banda “Vatra” shoqëroi Komitetin “Mbrojtja Kombëtare” dhe luftëtarët popullorë, më 3 shtator 1920, në manifestimet e fitores së Luftës së Vlorës.

Në shtator të vitit 2020, u bë dekorimi i kësaj Orkestre në 100-vjetorin e Luftës së Vlorës, nga institucionin i Presidentit të Republikës, me titullin e lartë “Kalorësi i Urdhrit të Flamurit”.

Në përfundim të luftës, orkestra frymore i dha atdheut dëshmorët e saj si Abdulla Beja dhe Vlash Parapani. Disa prej tyre të plagosur rëndë, si muzikanti partizan Petraq Quka, mbetën invalidë për tërë jetën.

Dukej se po përsëritej epopeja e Bandës VATRA: Me pushkë dhe vegël muzikore për Atdhën!

Historia e Orkestrës Frymore të Ushtrisë apo Bandës së Ushtrisë, pas çlirimit të vendit, është e pasur me koncerte e

aktivitete të shumta kulturore e artistike. Duke filluar me daljen e saj të parë zyrtare në Tiranë e çliruar, më 18 nëntor 1944, për të vijuar më tej me koncerte, përgatitjen e paradës së parë të forcave partizane, etj. Banda e Ushtrisë kishte ende në radhët e saj ish-muzikantët e VATRËS si dhe muzikantë të huaj, të cilët ishin angazhuar në formacionin e ri frymor në radhët e ushtrisë partizane. Detyrat e Bandës së Ushtrisë kanë qenë të shumta si në pritjet zyrtare shtetërore, në manifestime kulturore e sportive, ceremoni e parada ushtarake, përvjetorë e aksione kombëtare. Kontributi i saj po ashtu ka qenë shumë i madh, si për krijimin e orkestrës filarmonike shqiptare dhe të Ansambllit të Ushtrisë, ashtu edhe për rritjen cilësore të orkestrave të ndryshme ushtarake.

Orkestra Simfonike e Forcave të Armatosura është e vetmja orkestër frymore profesioniste në Shqipëri, pasardhëse e denjë e bandës “Vatra”.

Paraardhësit e muzikantëve, që sot shërbejnë në ceremonialin e shtetit, paradat ushtarake dhe festat kombëtare, ishin emigrantë, që gjatë javës punonin fabrikave dhe fermave bujqësore amerikane, dhe të dielave stërviteshin në instrumente, duke kënduar Marsejezën dhe Himnin Kombëtar Shqiptar.

Edhe sot pas shumë vitesh, shqiptarët nderojnë Bandën Kombëtare “Vatra”, si dhe sot Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura, të cilat mbartin simbolikën e shtetit shqiptar dhe të institucioneve të lidhura ngushtësisht me të. “Këto dy banda janë e djeshmja dhe e sotmja e një tradite të bukur muzikore shqiptaro-amerikane. Kjo traditë e ka zanafillën në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, me krijimin e Bandës Kombëtare “Vatra” nga Thoma Nasi, trashëgimia e të cilës vijon sot, pas 111 vitesh, me Orkestrën Simfonike të Forcave të Armatosura”, Vlerësimi që i bëhet edhe sot nga shqiptarët Bandës “Vatra” është nderim për të gjithë anëtarët e saj dhe drejtuesin Thoma Nasi, të cilët lanë Amerikën për të ndihmuar Atdheun, që deshën mbi gjithçka lirinë për vendin e tyre dhe që e shprehën këtë dashuri me muzikën e tyre.


“Një komb që arrinte të krijonte të tilla grupe si Banda “Vatra” dhe të donte muzikën aq sa njerëzit e shprehnin këtë me vërshimin nëpër koncerte, natyrisht që meritonte lirinë e tij”, - do të shprehej profesor Sederholm, pjesëtar i grupit të Lidhjes së Kombeve që monitoronte kufirin jugor të Shqipërisë në vitet 1920-të.



SKËNDERBEGASI ALEKSANDËR NIKOLLA, MUNDËS I NJOHUR ME EKIPIN “DINAMO”

Aleksandër Nikolla është një tjetër nxënës i shkollës “Skënderbej” që bëri emër në sportin burrorë të mundjes. Ai, për shumë vite ka përfaqësuar në sportin e mundjes, ekipin e parë të “Dinamos”. Aleksandri ka lindur, më 27 tetor të vitit 1955, në ishullin e Sazanit, ku banonin familjarisht për shkak se babai i tij officer, ishte caktuar me shërbim në këtë ishull. Në shtator të vitit 1979, Aleksandrit i del e drejta e studimit për në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”. Siç dihet, në atë periudhë, për nevoja të Ministrisë së Mbrojtjes, nga kjo shkollë dërgoheshin kontingjente të reduktuara në shkollat e tjera profesionale të Tiranës. Ky kontingjent, pjesë e të cilit ishte dhe Aleksandri, ishte me uniformë ushtarake, akomodohet (fjetje, ushqim) në shkollën “Skënderbej”, ndërsa mësimet e ditës i bënin në shkollat e Tiranës, ku ishin caktuar. Transporti i ndërsjellë për mësimet jashtë shkollës, ishte i organizuar me mjete të posaçme. Aleksandri u caktua për në ndjekur shkollën e mesme si skënderbegas në Teknikumin e Ndërtimit në “Qytetin e Nxënësve”. Në këtë shkollë ai ndoqi tre vite, pa arritur që të mbarojë maturën.

Që në vitet kur ishte skënderbegas, talenti në mundje që ishte shfaqur që në fëmijëri, u zhvillua më tej nën përkujdesjen e trajnerëve të njohur dhe Aleksandri u arrit të inkuadrohej në ekipin e parë të sport-klub “Dinamo”, që në atë kohë, ishte në vartësi të Ministrisë së Brendshme. Aleksandër Nikolla për dashurinë e tij të parë do shprehej: “Ruaj respektin më të madh për shokët në shkollën “Skënderbej”, për mësuesit dhe pedagogët e palodhur që krahas mësimit, interesoheshin dhe punonin pa u lodhur dhe për zhvillimin e talentit që ne kishim. Kujtoj me respekt shokët e mi Ylli Zulali, Ylli Basha, Sazan Xhaka, Petrit Karafili etj.; për komandantin e shkollës Meço Starja, komisarin e shkollës Agim Tepelena, për komandantin tim Ilirjan Hyseni, për mundësit skënderbegas Abedin Lame, Ndoc Ndoci, Ilirjan Qose, Agim Mazreku etj... Ndërsa rreth sportit të mundjes të cilit ai i kushtoi jetën shprehet: “Me ekipin ‘Dinamo’ unë u inkuadrova në vitin



1971 dhe e kam ushtuar këtë sport për gati 20 vite. Trajner kisha të mirënjohurin Riza Lofca. Jam aktivizuar në peshën e parë, 48 kilogram. Jam stërvitur e kam garuar me shokët e ekipit ku përmend Pëllumb Qosen, Maksim Bufin, Skënder Dodën, Vasillaq Sotën, Ylli

Kupin, Jak Nokën etj... Kam fituar disa vende nderi në kampionate e aktivitete të ndryshme kombëtare!”. Pas ndryshimeve të vitit 1990 që përkon dhe me largimin e Aleksandrit nga sporti i mundjes, ai shkon familjarisht në emigracion në Greqi.

FATMIR SHANI, GJIMNAST I NJOHUR I EKIT “PARTIZANI”

Fatmir Shani, skënderbegas i viteve 1974-1982, krahas formimit si ushtarak dhe karrierës në Forcat e Armatosura, ka shënuar suksese dhe në sportin e bukur të gjimnastikës. Ai ka qenë pjesë e ekipeve zinxhir të këtij ekipi, që nga muajt e parë, kur shkoi në shkollën “Skënderbej”, ku u evidentua si talent në këtë fushë. Ai, falë talentit, pasionit e punës me përkushtim, krahas të tjerave, arriti që të shpallet dhe dy herë kampion kombëtar me ekipin “Partizani”, duke fituar dhe shumë vende nderi në aktivitete të tjera kombëtare. Për shkak të një dëmtimi të parikuperueshëm fizik, ai u detyrua që të ndahet nga gjimnastika në moshë të re, por jo nga pasioni për këtë sport të bukur. Por tashmë, në rolin e trajnerit, profesion të cilin e ushtron dhe tani në emigracion, ku u detyrua të shkojë në SHBA pas ndryshimeve politike të vitit 1990.



Fatmir Shani u lind në Tiranë, më 2 shkurt të vitit 1956. Arsimin fillor e mori në shkollën “11 janari” të kryeqytetit dhe më pas, atë tetëvjeçar në shkollën “Liri Gero” të Fierit, qytet në të cilin shkuan të banonin familjarisht për shkak se babai i tij ishte officer dhe u transferua në këtë qytet. Në shtator të vitit 1970, Fatmir Shani nisi studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme Ushtarake “Skënderbej”, të cilën e përfundoi në vitin 1974.

Më, pas, ai kreu dhe studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të Oficerëve “Enver Hoxha”, ku pas diplomimit u mbajt si pedagog e komandues në këtë shkollë, duke shënuar dhe periudhën më të mirë të tij si sportist elitë në vend në sportin e gjimnastikës. Pas dëmtimit të rëndë në stërvitje, rreth moshës 28-29 vjeç, ai nuk mund të ushtronte më gjimnastikën, por punoi si officer aktiv në disa reparte e njësi të Tiranës. Në vitin 1993 nxirret në lirim dhe në vitin 1996 emigron familjarisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës.

Rezultatet në sportin e gjimnastikës për Fatmir Shanin nisin që në vitin 1970, kur ai sapo kishte shkuar skënderbegas e u bë pjesë e ekipit përfaqësues të shkollës në këtë sport e në pak javë, edhe pjesëtar i “Partizanit”. Ai ishte pjesë e një grupi sportistësh të rinj gjimnastë që patën sukses në këtë sport, ku përmenden Ramazan Zelia, Aqif Speci, Luan Lamaj që ishte shok i ngushtë i tij e njëkohësisht bashkënxënës në të njëjtën klasë etj... Në fillim të vitit të tretë të shkollës, Fatmiri bëhet pjesëtar i ekipit të parë të gjimnastikës në klubin “Partizani”. Trajner kishte të mirënjohurin Xhavit Xhani dhe më pas, Ilir Bathon. Krahas dy titujve kampioni kombëtar me këtë ekip, ai ka marr disa vende të dyta në shkallë vendi, duke qenë ndërkohë dhe fitues i vendit të parë në shumë spartakiada kombëtare. Edhe pse në emigracion në SHBA, Fatmiri nuk ndahet nga gjimnastika. Prej kohësh, ai stërvit atje një ekip moshash në këtë sport

HAZIZ ÇEÇO: SHKOLLA “SKËNDERBEJ”, KU UNË NISA KARRIERËN TIME SI FUTBOLLIST

Nëse unë kam bërë një emër në sportin e futbollit, këtë ia dedikoj fatit tim që mu dha e drejta të nis studimet në Shkollën e Mesme të Përgjithshme “Skënderbej” dhe të kisha trajner të njohur në këtë sport, që nga ai i pari që më evidentoi si talent, Sherif Çiçiku, e deri tek emrat e njohur Panajot Pano, Refik Resmja, Prokop Riza, Iljaz Dingu etj...

Unë jam me origjinë nga Skrapari, por kam lindur, më 6 janar të vitit 1958, në Konispol të Sarandës, ku për shkak të detyrës së babait tim si officer, banonim familjarisht atje. Arsimin tetëvjeçar e kam kryer në shkollën “Irfan Tomini” të Peshkopisë, qytet në të cilin u shpërngulëm familjarisht për shkak të emërimit të babait tim në këtë qytet kufitar. Më 1 shtator të vitit 1973, më jepet e drejta e studimit në shkollën “Skënderbej”. Pikërisht, këtu në këtë shkollë, që në ditë e para të akomodimit, ishte i pasionuari Sherif Çiçiku (personi që ka zbuluar e stërvitur dhjetëra breza skënderbegasish në dekada, që u bënë pjesë e ekipit të ‘Partizanit’ dhe atij kombëtar). Unë kisha dëshirë si çdo fëmijë të luaja futboll e luaja vazhdimisht, por nuk dija se ky do të ishte moment (shkolla “Skënderbej”), që unë do i kushtohesha këtij sporti. Pra, pas evidentimit të talentit tim nga Sherif Çiçiku, unë bëhem pjesë e ekipit përfaqësues të futbollit të shkollës, e njëkohësisht, pjesë e ekipit të të rinjve të ekipit “Partizani”. Ishte ikona e futbollit shqiptar Panajot Pano, që sugjeroi përfshirjen time në këtë ekip. Njëkohësisht, duke iu përkushtuar sportit që në vitin e parë të shkollës, unë bëja përpjekje që të përvetësoja dhe programin mësimor edukativ, që në fakt, ishte shumë i ngarkuar. Kujtoj se atë vit, klasa ime (I-4), kishte komandues ushtarakë Shahin Muho e Guri Rakipi. Ndërsa mësuesit e grupit tonë ishin Marjeta Berati, Isak Mezini, Skënder Shkupi, Sashenka Rino, Liljana Nakuçi etj... Kujtoj me respekt shokët e klasës Arjan Ahmeti, Arjan Adhami, Harilla Filipi, Bujar Shehu, Maksim Dauti, Engjëll Halili, Minella Balliu etj. Disa nga këta, unë do i kisha dhe shokë të ekipit përfaqësues të shkollës dhe tek “Partizani”.

Pas përfundimit të shkollës në vitin 1977, sipas rregullit, para se të ndiqnim shkollën e lartë ushtarake, shkua një vit në prodhim. Unë, si sportist që isha, dhe me një afër emir sigurisht, vitin e stazhit në prodhim e bëra si futbollist pranë ekipit “5 Shtatori” të Skraparit. Në shtator të vitit 1978, nis studimet në Shkollën e Lartë të Bashkuar të oficerëve në Tiranë, duke u rikthyer njëkohësisht dhe në ekipin e “Partizanit”.... Në këtë periudhë grumbullohem dhe me ekipin e parë të “Partizanit”. Tashmë futboli ishte bërë pjesë kryesore e jetës sime. Në vitet 1980-1981 luaj futboll me ekipin e Skraparit, për të vazhduar më pas, në vitet 1981-1984 me ekipin “Labinoti” të Elbasanit”. Në vitin 1984, rikthehem përsëri në Skrapar, ku luajta deri në kohën që e lash futbollin si lojtar. Pasi lash futbollin si lojtar, për katër vite rresht isha trajner i ekipit “5 Shtatori” të Skraparit. Në vazhdim, për 17 vite rresht kam punuar si mësues i edukimit fizik. Aktualisht, punoj pranë Gardës së Republikës në Tiranë.



